



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DEPARTAMENTI LIGJOR DHE PROKURIMEVE
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE**

Datë 10.03.2023

PROCESVERBAL–Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

"Sistemim i përroit të hapur në rrugën:"Engjëll Mashi", "Loni Ligori", Yzberisht".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimore – kod 45

VLERA E FONDIT LIMIT: 20,578,567 (njëzet milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Argumentimi: Bazuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në VKM Nr.629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto x

Sipas rëndësisë:

Çmimi <input type="checkbox"/>	pikët 50
Stafi / Organizimi i Kompanise <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	pikët 25
Koha e punimeve (grafiku i punimeve) <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit / <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	pikët 15

Bazuar në pikën 4 neni 45 të VKM 285 datë 19.05.2021 ku autoriteti mund të mbeshtetet në ofertën ekonomikisht më të favorshme të bazuar në kosto.

Bazuar në natyrën e punimeve dhe vlerën e objektit që do të prokurohet është parë e arsyeshme që vlerësimi i këtij objekti të bazohet në ofertën ekonomikisht të bazuar në kosto, për cilësinë, meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin, organizimin, kualifikimin, përvojën e stafit dhe procesin e dorëzimit, periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3; në vlerën 2% të fondit limit: **411,571.34** (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht : **8,231,426.8(tetë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e gjashtë presje tetë) lekë pa t.v.sh.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$40\% \times 20,578,567 = \mathbf{8,231,426.8}$$

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshem gjatë 3(tre) viteve të fundit 2019, 2020, 2021(Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, *nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*, konkretisht : **8,231,426.8 (tetë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e gjashtë presje tetë) lekë pa t.v.sh .**

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht : **41,157,134 (dyzetë e një milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e katër) lekë pa t.v.sh,** datë e përlllogaritur *nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, datë e përllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$40\% \times 20,578,567 = \mathbf{8,231,426.8}$$

$$20,578,567 \times 2 = \mathbf{41,157,134}$$

- 2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MPPT/MTI , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:
- NP-1/A Punime gjurmimi në tokë.
 - NP-7/A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë për ekuivalentimin e licencës së huaj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi për kategoritë e licencave si më poshtë:

NP-1/A Preventivi përfshin Punime gjurmimi në tokë

NP-7/A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kerkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gjermimi në tokë	Ger. Dheu me esk, Germim dheu me krahe, mbushje me zhavorr, shtrese stabilizanti, shtrese beton, themele me xokol betoni, Prerje sistemim pemesh, perforcime gjermimi nenshtrese zhavorri, rrethim me rrjete teli.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.
NP-7A	Ujësjellësa, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.	F.V tub i brinjezuar HDPE SN8, F.V tub betoni, F.V. Pusea shkarkim betoni, F.V. Puseta sipas vizatimit (MH1, MH5), perimetri i pusetes P=10 ml H=3-3.5 ml, P=6 ml H=3 ml.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik drejtues teknik në licencën e e shoqërisë.

Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit (**Shkurt 2023**) për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4. Operatori ekonomik, realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **stafin mbështetës**, si më poshtë:

a. 1 (një) inxhinier Ndertimi

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit (**Shkurt 2023**) për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Bazuar në natyrën e punës që do të kryhet për realizimin e objektit, specifikimeve teknike dhe zerave të preventivit operatori duhet të ketë informacion të nevojshëm lidhur me të dhënat që kërkon projekti sipas sipas specifikimeve teknike. Për këtë arsye krahas drejtuesve teknik është kërkuar edhe stafi mbështetës.

Cilesia e punës duhet të jete e tille që të arrihen standartet e kerkuara dhe të plotesoje kushtet teknike të zbatimit në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve referuar vendit ku do të kryhet puna, duhet të jete i licensuar lidhur me kategorinë **III.2.B** ku specifikohen veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme për të cilën shoqëria ofertuese duhet të paraqesë licencën përkatëse, sipas kërkesës për kualifikim.

Argumentimi: Në bazë të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA “III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË III.2.B”, specifikisht “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

Në bazë të zërave në preventiv, specifikimeve teknike dhe natyrës së objektit që do të prokurohet është e nevojshme dhe licenca lidhur me kategorinë **III.2.B**.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1) Grupi I- 2(dy) punonjës
- 2) Grupi II-2(dy) punonjës
- 3) Grupi III-1(një) punonjës

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit (**Shkurt 2023**) për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

- ***Nëse operatori ekonomik paraqet punonjës të një kategorie më të lartë se ato që janë kërkuar në pikën 2.3.5 , nuk përben kusht për skualifikim.***
- ***Nëse operatori ekonomik paraqet punonjës të një kategorie më të lartë se ato që janë kërkuar në pikën 2.3.5 , nuk përben kusht për skualifikim.***

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Ky kriter është vendosur *bazuar edhe ne volumin e punimeve si dhe ne zerat e preventivit.*

Qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është kryerja e punimeve të kontratës objekt prokurimi në përputhje me cilësinë e kërkuar dhe nga staf teknik i kualifikuar. Për arritjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar me IQT të kategorive te ndryshme si rezultat i punës mjaft komplekse që do të realizohet në disa fronte të cilat kërkojnë aftesi teknike dhe profesionale te kategorive specifike duke filluar nga **Grupi i I** ne te cilin klasifikohen punonjësit e thjeshtë, (bojaxhinj, punonjës provë, apo personeli i reparteve të centralit, të cilët nuk duhet të njohin rregulloren e sigurimit teknik, psh pastrues të impianteve, mekanikë, saldatorë, drejtues të vinçave, etj). **Grupi i II** ku klasifikohen praktikantëve të shkollave profesionale elektrike dhe inxhinierisë, kontrollorëve të linjave, saldatorëve, telefonistëve, elektropompistëve, të gjithë elektricistëve me kualifikim të ulët, **Grupi i III** te cilit i përket personelit elektromekanik, elektroteknik, gjithë specialistëve përgjegjës të ndërtesës në central, nënsta, impiante shpërndarëse dhe një rrjetin elektrik , dhe personelit elektrik që punojnë në kompanitë e telekomunikacionit, **Grupi IV** të cilit i përket teknikeve dhe inxhinierëve të rinj, personelit në central nënstatione dhe rrjete elektrike, elektroteknik, mjeshtër elektromontier dhe duke përfunduar me **Grupin V** i cili u përket u përket mjeshtërve, teknikëve elektrikë dhe inxhinierëve.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilët një automakinist dhe një eskavatorist.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, dëshminë përkatëse si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit (**Shkurt 2023**) për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Sipas percaktimeve të përgjithshme dhe kërkesave për punimet e germimeve në toke (në vëllim dhe me shtesa) dhe germimet për struktura në kanale, përfshirë germimin nën ujë.

Germimi në dhëra duhet të aplikohet në të gjitha materialet që mund të gërmohen si me krahe ashtu dhe me makineri. Ky kriter është vendosur *bazuar edhe në vëllimin e punimeve si dhe në zerat e preventivit.*

2.3.8 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt,

- 1 (një) specialist për montim tubash
- 1 (një) hidraulik
- 1 (një) elektrikist

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, dëshminë përkatëse si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit (**Shkurt 2023**) për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Bazuar në vëllimin e punimeve dhe zerave në projekt-preventiv dhe specifikimet teknike janë percaktuar specialistet e sipërcituar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 20 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Shkurt 2023**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shkurt 2023**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Llogaritja e numrit të punëtorëve është bërë bazuar në vëllimin e punimeve që do të kryhen sipas preventivit të punimeve në zbatim të VKM Nr 629 datë 15.07.2015, Për Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre.

Praktikisht :

Vëllimi i punimeve në leke:Pagën orare: orë/ditë: ditëpunë/muaj: afatin kohor të punimeve = Nr i punëtorëve.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", *Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të disponojë punonjësin, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit (**Shkurt 2023**) për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht bazuar në ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

2.3.11 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve:

- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilesisë së punimeve **ISO 9001- 2015** (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001-2015** (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **PAS 99-2012**(e vlefshme).(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi: Bazuar në 44 “Kerkesat e cilesisë” te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë kërkuar çertifikata ISO.

2.3.12 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine për ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Pjate vibruese	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makinëritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sh.a (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se Kontrates, të gjithë dokumentacionin provues për makinëritë e mesipërme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinërive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perlllogaritja e oreve te punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Kerkesat e mesiperme jane te mbeshtetura ne zerat e punimeve qe jane parashikuara ne preventiv si edhe ne krijimin e besueshmerise se AK ne zoterimin e kualifikimeve te nevojshme teknike, profesionale , kapacitetet organizative , aftesite organizative, makinërite apo pajisje te tjera asete

fizike te nevojshme per te zbatuar kontraten ku autoriteti kontraktor kerkon deshmi per personelin kryesor qe ka ne dispozicion OE, **duke qene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesite zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates per te krijuar besueshmerine publike nga OE per realizimin me efikasitet dhe eficence te kontrates.**

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike te ngarkuara ne sistemin e APP-se jane hartuar nga specialistet perkates se teknikes.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.